




DOKUMENTACIONI I PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT TË TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A.

2022

PËRMBAJTJA

1. RREGULLORE PËR SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS ME SHTOJCAT:

- a)** SHTOJCA 1 SKEMA ORGANIZATIVE E TK SH.A.
- b)** SHTOJCA 2 PËRSHKRIMET E VENDEVE TË PUNËS
- c)** SHTOJCA 3 UDHËZUESI PËR VLERËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS
- d)** SHTOJCA 4 TABELA E VENDEVE TË PUNËS
- e)** SHTOJCA 5 UDHËZUESI DHE PROCEDURAT PËR AVANCIMIN E INXHINIERËVE SIPAS SHTEGUT PROFESIONAL

2. RREGULLORE PËR SISTEMIMIN NË VENDET E PUNËS GJATË PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT DHE RIORGANIZIMIT NË TELEKOMIN E KOSOVËS SH.A.

3. RREGULLORE PËR PAGAT SHITESAT MBI PAGË DHE KOMPENSIMET TJERA

Telekomi i Kosovës SH. A.
Kosovo Telecom J. S. C.
Telekom Kosovo D. D.
Nr./No./Br. 01-3943/22
Data/Date/Datum 13-09/22.
PRISHTINË, PRISTINA, PRIŠTINA



TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Në mbështetje të Ligjit të Punës nr.03/L-212 ("Ligji i Punës"), Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 ("Ligji për Ndërmarrje Publike"), Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ("Ligji për Shoqëri Tregtare"), dispozitave të Statutit të Telekomit të Kosovës Sh.A.,

Bordi i Drejtoreve i Telekomit të Kosovës Sh.A. në mbledhjen Nr. 30 të datës 31.08.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS NË TELEKOMIN E KOSOVËS SH.A.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi	3
Neni 2 - Fushëveprimi	3
Neni 3 - Përkufizimet	3

KAPITULLI I

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I TK Sh.A

Neni 4 - Struktura e përgjithshme organizative	4
--	---

KAPITULLI II

SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS

Neni 5 - Numri i stafit dhe emërtimi i vendeve të punës	4
Neni 6 - Vlerësimi dhe gradimi i vendeve të punës	4
Neni 7 - Kriteret për klasifikimin e vendeve të punës	4
Neni 8 - Kategoritë funksionale të vendeve të punës – brezat	5
Neni 9 - Gradat dhe hapat e gradimit	6

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10 - Dispozitat kalimtare	6
Neni 11 - Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores	6
Neni 12 - Hyrja në fuqi	6

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

1.1. Kjo rregullore përcakton organizimin e brendshëm të Telekomit të Kosovës Sh.A ("TK Sh.A." ose "Telekomi i Kosovës"), duke përfshirë: funksionimin dhe menaxhimin e njësisë organizative, sistemimin e vendeve të punës në funksione përkatëse, emërtimet e funksioneve dhe përshkrimin e detyrave të punës si dhe kualifikimet e nevojshme për secilin vend pune, me qëllim të kryerjes efikase të detyrave të punës.

1.2. Të gjitha shtojcat e kësaj rregulloreje, sikurse mund të ndryshohen dhe plotësohen në përputhje me procedurat e parashikuara, janë pjesë integrale e saj.

Neni 2 - Fushëveprimi

2.1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha njësitë organizative dhe punonjësit e TK Sh.A.

Neni 3 - Përkufizimet

3.1. Për nevojat e kësaj Rregulloreje, shprehjet e përdorura kanë këto kuptime:

3.1.1. "Bordi i Drejtorëve" i TK Sh.A. - nënkupton organin më të lartë, të përcaktuar sipas nenit 15 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009 ("Ligji për Ndërmarrje Publike") dhe Statutit të TK Sh.A.

3.1.2. "KE" - Kryeshefi Ekzekutiv i TK Sh.A nënkupton Zyrtarin Kryesor të Telekomit të Kosovës Sh.A të zgjedhur sipas nenit 21, lidhur me nenin 17, të Ligjit për Ndërmarrje Publike.

3.1.3. "ZKFTH" - nënkupton Zyrtarin Kryesor të Financave dhe Thesarit, të zgjedhur sipas nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

3.1.4. "KP/SK" - nënkupton Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin e Ndërmarrjes, të zgjedhur sipas nenit 21 të Ligjit të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

3.1.5. "ZAB" - nënkupton Zyrtarin e Auditimit të Brendshëm, të zgjedhur sipas nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

3.1.6. "Zv.KE" - nënkupton zëvendësin e Kryeshefit Ekzekutiv të TK Sh.A., të zgjedhur sipas nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

3.1.7. "Punonjës" - nënkupton personelin e punësuar në TK Sh.A.

3.1.8. "Vendi i punës" apo "pozita e punës" - kanë kuptimin e njëjtë, por njëri apo tjetri emërtim përdoret përshtatshëmrisht me kontekstin e fjalisë.

3.1.9. "Strukturë organizative" - nënkupton organizimin e njësisë përbërëse dhe sistematizimin e punonjësve përbrenda tyre.

3.1.10. "Grada" - është vlerë numerike, e cila reflekton pozicionin e një vendi të punës në hierarkinë e përgjegjësisë dhe pagën.

3.1.11. "Paga" - nënkupton vlerën monetare që përfitojnë punonjësit si rezultat i gradës për angazhimin e tyre në punë.

KAPITULLI I

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I TK Sh.A

Neni 4 - Struktura e përgjithshme organizative

4.1. Struktura Organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A. në nivelin e parë është si vijon:

- Kryeshefi Ekzekutiv;
- Zëvendësi i Kryeshefit Ekzekutiv;
- Zyra e Kryeshefit Ekzekutiv;
- Sekretari/ Këshilltari i Përgjithshëm;
- Zyra e Auditimit të Brendshëm;
- Drejtoria për Financa dhe Thesar;
- Drejtoria për Teknikë dhe Teknologji Informative;
- Drejtoria për Marketing, Shitje dhe Kujdes ndaj konsumatorëve dhe
- Drejtoria për Çështje të Korporatës.

Struktura organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A. në nivelin e parë, në formë grafike (të organogramit), është paraqitur në **Tabelën 1**.

4.2. Struktura e përgjithshme organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A. në formë grafike (të organogramit), është paraqitur në **Shtojcën 1**, të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

KAPITULLI II

SISTEMATIZIMI I VENDEVE TË PUNËS

Neni 5 - Numri i stafit dhe emërtimi i vendeve të punës

5.1. Numri i stafit në Telekomin e Kosovës Sh.A. përcaktohet me Planin e Biznesit.

5.2. Emërtimi i të gjitha vendeve të punës në TK, përshkrimi i tyre, klasifikimi dhe gradat përkatëse janë përcaktuar në dokumentin "Përshkrimi i vendeve të punës në Telekomin e Kosovës Sh.A.", në **Shtojcën 2** të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 6 - Vlerësimi dhe gradimi i vendeve të punës

6.1. Secili vend i punës vlerësohet në bazë të përshkrimit të tij sipas "Udhëzuesit për vlerësimin e vendeve të punës në Telekomin e Kosovës Sh.A".

6.2. Dokumenti "Udhëzuesi për vlerësimin e vendeve të punës", i cili përcakton procedurat, kriteret dhe hapat për vlerësimin dhe gradimin e vendeve të punës, është paraqitur në **Shtojcën 3** të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 7 - Vlerësimi dhe gradimi i vendeve të punës

7.1. Kriteret e përgjithshme për klasifikimin e vendeve të punës janë:

7.1.1. Llogaridhënia dhe Përgjegjësia - përcakton nivelin e llogaridhëniës dhe përgjegjësisë së vendit të punës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të TK Sh.A.;

7.1.2. Vendimarrja - përcakton nivelin e vendimarrjes së vendit të punës në ushtrimin e detyrave për realizimin e objektivave të TK Sh.A.;

7.1.3. Kompleksiteti - përcakton nivelin e ndërlikueshmërisë dhe llojshmërisë së detyrave të punës;

7.1.4. Aftësitë komunikuese ndërpersonale - përcaktojnë nivelin e aftësive të komunikimit që nevojiten për vendin e punës;

7.1.5. Kualifikimet – përcaktojnë nivelin e arsimimit, trajnimeve dhe njohurive përkatëse për ushtrimin e detyrave të vendit të punës;

7.1.6. Përvoja profesionale - përcakton përvojën e punës në ose jashtë TK Sh.A në nivelin dhe detyrat e përafërta profesionale.

Neni 8 - Kategoritë funksionale të vendeve të punës – brezat

8.1. Vendet e punës në TK Sh. A. në bazë të "Udhëzuesit për vlerësimin e vendeve të punës" (Shtojca 3) ndahen në gjashtë kategori funksionale - breza:

8.1.1. Niveli i Menaxhmentit Ekzekutiv (Brezi F) në Telekomin e Kosovës Sh.A., është pozitë përgjegjëse për llogaridhënien, udhëheqjen dhe menaxhimin e Telekomit të Kosovës Sh.A., për të siguruar se të gjitha funksionet dhe aktivitetet e TK-së përmbushen në mënyrë efikase. Merr vendime strategjike dhe operative që vlejné për një drejtori, disa drejtori dhe TK-në në tërësi. Vendimet në këtë nivel kufizohen vetëm nga Statuti i ndërmarrjes dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Në brezin e nivelit të Menaxhmentit Ekzekutiv (Brezi F) përfshihen vendet e punës me gradat 16, 17 dhe 18.

8.1.2. Niveli i Menaxhmentit të Lartë (Brezi E) është pozitë përgjegjëse për menaxhimin dhe koordinimin e punës në fushë të caktuar të veprimtarisë së TK. Sh.A. Vendimet në këtë nivel bazohen në strategjitë dhe procedurat e përgjithshme të drejtorive dhe TK-së, sipas Matricës së autorizimeve të TK-së. Në këtë nivel caktohen objektivat kryesore të një funksioni apo departamenti kryesor ose për disa funksione brenda drejtorisë. Kontribuon në planet strategjike dhe afariste të drejtorisë dhe TK-së. Në brezin e nivelit të Menaxhmentit të Lartë (Brezi E) përfshihen vendet e punës me gradat 14 dhe 15.

8.1.3. Niveli i Menaxhmentit (Brezi D) kontribuon përmes menaxhimit operativ të burimeve domethënëse brenda një njësie, duke përfshirë edhe menaxhimin e profesionistëve të aftë dhe sigurimin e ekspertizës dhe njohurive në një çështje që ka të bëjë me njësinë. Në këtë nivel, vendimet kanë të bëjnë me ekzekutimin e planeve operative dhe planifikimin e burimeve për t'i arritur objektivat për një zyre, nënsektor, sektor, funksion ose departament brenda një njësie. Nga ky nivel mund të kërkohej dhënia e kontributit në planet strategjike dhe afariste në nivel njësie. Në brezin e nivelit të Menaxhmentit (Brezi D) përfshihen vendet e punës me gradat 12 dhe 13.

8.1.4. Niveli Mbikëqyrje/Specializuar (Brezi C) kontribuon përmes mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë të punonjësve me më pak shkathtësi ose përmes ofrimit të shkathtësive të specializuara dhe ekspertizës profesionale. Në këtë nivel, vendimet merren sipas rregullave të përcaktuara, ligjeve, standardeve, rregulloreve, procedurave dhe praktikave të përcaktuara. Në brezin e nivelit Mbikëqyrje/Specializuar (Brezi C) përfshihen vendet e punës me gradat 9, 10, dhe 11.

8.1.5. Niveli Administrativ/Teknik (Brezi B) kontribuon në zgjedhjen e përdorimit të pajisjeve apo veglave dhe aplikimit të procedurave përmes gjykitimit të shëndoshë. Në këtë nivel vendimet janë të kufizuara në zgjedhjen midis procedurave alternative administrative ose teknike. Në brezin e nivelit Administrativ/Teknik (Brezi B) përfshihen vendet e punës me gradat 5, 6, 7 dhe 8.

8.1.6. Niveli Operativ (Brezi A) kontribuon duke kryer punë të natyrës operative dhe duke i ofruar të tjerëve ndihmë bazike. Në këtë nivel nuk ka marrje të vendimeve ose ato janë të kufizuara pasi që kryerësi i punës kryesisht i zbaton udhëzimet e drejtpërdrejta. Në brezin e nivelit Operativ (Brezi A) përfshihen vendet e punës me gradat 1, 2, 3 dhe 4.

8.2. Karakteristikat e kategorive funksionale të vendeve të punës, të përcaktuara në pikën 8.1., vlejné edhe për emërimin e të punësuarit si ushtrues detyre, sipas nenit 11.3 dhe 11.4 të Rregullores për Marrëdhënie të Punës, Nr. 01-2978/22.

8.3. Për vendet e punës në TK Sh.A të klasifikuara me grada të shprehura në vlera numerike, nga grada një (1) deri deri në gradën njëmbëdhjetë (11), lidhen kontrata të punës në kohë të pacaktuar.

8.4. Për vendet e punës në TK Sh.A të klasifikuara me grada të shprehura në vlera numerike, nga grada dymbëdhjetë (12) deri në gradën tetëmbëdhjetë (18), lidhen kontrata të punës në kohë të caktuar.

Neni 9 - Gradat dhe hapat e gradimit

9.1. Vendet e punës në TK Sh.A klasifikohen me grada të shprehura në vlera numerike, nga ajo më e lartë - tetëmbëdhjetë (18), me hapin një (1), deri te grada më e ultë - një (1).

9.2. Vlera e pagës për secilën gradë përcaktohet me akte të veçanta (Rregullore për paga, shtesat mbi pagë, kompensime tjera dhe ndalesat në pagë) nga Bordi i Drejtorëve dhe në bazë të Politikës për Kompensimin e Zyrtarëve të Lartë të Korporatës.

9.3. Dokumenti "Tabela e vendeve të punës në TK Sh.A.", i cili përmban emërtimet e të gjitha vendeve të punës dhe gradat përkatëse, është paraqitur në **Shtojcën 4** të kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.

9.4. Dokumenti "Udhëzuesi dhe Procedurat për avancimin e Inxhinierëve sipas shtegut profesional", i paraqitur si **Shtojca 5** e kësaj Rregulloreje, rregullon avancimin e inxhinierëve në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në atë dokument, dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 10 - Dispozitat kalimtare

10.1. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj rregulloreje është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, ose është më kufizuese se legjislacioni, dispozita e tillë konsiderohet e pavlerë dhe pa efekt, ndërsa dispozitat tjera të Rregullores interpretohen në qëllim të plotësisht dhe sigurimit të zbatimit të Rregullorës.

10.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen të gjitha aktet e brendshme që kanë të bëjnë me organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në TK Sh.A.

Neni 11 - Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

11.1. Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Bordi i Drejtorëve, në përputhje me nevojat ligjore dhe organizative.

Neni 12 - Hyrja në fuqi

12.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën 13-09-2022.

z. Shpëtim Dobra

Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A.










Tabela 1. Struktura Organizative e Telekomit të Kosovës Sh.A. në nivelin e parë











- Zv Kryeshefi Ekzekutiv nuk është parapare nga komisioni, por është vendose si mundësi me vendim të Bordit të Drejtoreve





LEGENDA






Verejtje: Ne njesite/funksiomet e vecanta ne kuader te Kontabilitetit financiar e qe ne baze te numrit te anetareve te njesise nuk plotesojne kushtin e trajtimit si ekip (Tatimet, Mjetet themelore dhe Raportimi financiar), mbetet pergjegjesi e Menaxherit / Drejtorit perkates qe numrin e ekzekutuesve ta percaktoje sipas nevojës reale



LEGJENDA

Kryeshefi	Departamenti	Nërsëktor	Zyrtari
Njësia	Sëktori	Ekipi	Zyra Administrative




LEGJENDA

 Kryeshefi	 Departamenti	 Nënsektori	 Zyrtari
 Njësia	 Sektori	 Ekipi	 Zyra Administrative



TEKNIKA DHE T.I.

ZYRA ADMINISTRATIVE

- Asistent/e
- Administrator/e**Sqarim:**

Në të gjitha njesitë tjera, përveç regjioneve, konsiderohet se ka nevojë për njohuri dhe përvojë profesionale të avancuara në nivelin e Inxhinierëve të Lartë (IL) dhe Inxhinierëve Ekspertë (IE). Ata nuk janë paraqitur në mënyrë të veçantë në skemë në njesitë qendrore të Drejtorisë së Teknikës dhe TI. Rangimi i Inxhinierëve të Lartë dhe eventualisht i Inxhinierëve Ekspertë do të bëhet me komision, me kritere dhe procedurë të veçantë bazuar në akte të brendshme të TK.

LEGJENDA

Kryeshef


Departament

Nënshef

Zyrtari

Telekom Kosovo, J. S. A.


Telekom Kosovo, D. O. O.



LEGJENDA

Kryeshafi	Departamenti	Nënspektori	Zyrtari
Nënkryeshafi	Kolibr	Fkimi	Zyra Administrative

PRISHTINA



Verejtje:

1) Dy pozitat më të larta të avancimit profesional sipas shtegut profesional: Inxhinier Ekspert dhe Inxhinier i Lartë nuk mund të arrihen në njësitë regionale. Prandaj personeli nga këto njësi, që plotëson kriteret për këto avancime duhet të kalojë në njësitë tjera, ku këto avancime parashihen.


2) Në të gjitha njësitë tjera, përveç regjioneve, konsiderohet se ka nevojë për njohuri dhe përvojë profesionale të avancuara në nivelin e Inxhinierëve të Lartë (IL) dhe Inxhinierëve Ekspertë (IE). Ata nuk janë paraqitur në mënyrë të veçantë në skemë në njësitet qendrore të Drejtorisë së Teknikës dhe TI. Rangimi i Inxhinierëve të Lartë dhe eventualisht i Inxhinierëve Ekspert do të bëhet me komision, me kriteret dhe procedurë të veçantë bazuar në akte të brendshme të TK.



LEGJENDA

Kryeshefi	Departamenti	Në sektor	Zyrtari
Njësia	Sektori	Ekipi	Zyra Administrative

REGJIONET TJERA



Sqarim:

1) Dy pozitat më të larta të avancimit profesional sipas shtegut profesional: Inxhinier Ekspert dhe Inxhinier i Lartë nuk mund të arrihen në njësitë regjionale. Prandaj personeli nga këto njësi, që plotëson kriteret për këto avancime duhet të kalojë në njësitë tjera, ku këto avancime parashihen.

2) Zyrtarët e BNI ne regjione janë njëkohësisht edhe udhëheqës organizativ të njesive logjistike të regjioneve. Në aspektin e proceseve të punës zyrtarët respektiv të logjistikës i përgjigjen njesive homologe qendrore

3) Në të gjitha njësitë tjera, përveç regjioneve, konsiderohet se ka nevojë për njohuri dhe përvojë profesionale të avancuara në nivelin e Inxhinierëve të Lartë (IL) dhe Inxhinierëve Ekspertë (IE). Ata nuk janë paraqitur në mënyrë të veçantë në skemë në njesite qendrore të Drejtorisë së Teknikës dhe TI. Rangimi i Inxhinierëve të Lartë dhe eventualisht i Inxhinierëve Ekspert do të bëhet me komision, me kriteret dhe procedurë të veçantë bazuar në akte të brendshme të TK.

4) Zyrtarët në regjione në vijim: përfaqësues ligjor, zyrtar për arkëtimin e borxheve dhe IT-së janë të paraqitur në skemat organizative të njesive përkatëse në qendër.

5) Zyrtarët e shitjes dhe logjistikës në regjione në kuadër të proceseve të punës udhëhiqen nga njësitë qendrore përkatëse, ndërsa në aspektin organizativ nga menaxheri regional


LEGJENDA

Kryeshefi	Departamenti	Në sektorin	Zyrtari
Njësia	Sektor	Ekipi	Zyra Administrative




RRJETI QENDROR


RRJETI QENDROR MOBIL




RRJETI RADIO MOBIL



IP & TRANSPORT BACKBONE



RRJETI QENDROR FIKS



*Me rastin e zgjerimit te rrjetit, shtimit te sherbimeve dhe pajisjeve, mund te paraqitet nevoja per plotesimin e stafit me kuader profesional

Prishtine, 12.05.2019
Kosovo Telecom, J.S.C.
Telekom Kosovo, D.O.O.

PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI

PLANIFIKIMI RADIO

PLANIFIKIMI FREKUENCOR MOBIL

Kryeinxhinier	
Inxhinier specialist	
Kryetehnik	

PLANIFIKIMI I TRANSPORTIT

Inxhinier specialist	
Inxhinier	

NDERTIMI I RRJETIT MOBIL

Inxhinier specialist	
Inxhinier	

OPTIMIZIMI RADIO

OPTIMIZIMI I RRJETIT MOBIL

Kryeinxhinier	
Inxhinier specialist	
Inxhinier	

ANALIZE DHE PERPUNIM I MATIEVE

Inxhinier specialist	
Inxhinier	
Kryetehnik	

PLANIFIKIM DHE PROJEKTIM I RRJETAVE KABLORE

Kryeinxhinier	
Inxhinier specialist	
Inxhinier i ndertimatarise	
Kryetehnik	

MENAXHIMI I PROJEKTEVE

MONITORIM DHE KONTROLLE

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Inxhinier	
Kryetehnik	
Zyrtar	

MENAXHIMI I KONTRATAVE

Kryesues	
Zyrtar nderlidhes	
Zyrtar	

DOK. TEKNIK ME STANDARDE

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Kryetehnik	



RRJETI I QASJES

RRJETI I QASJES MOBIL

RADIO (BTS & IP/TRANSPORT)

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Inxhinier	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS	

MONITORIM

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Inxhinier	
Operator	
Zyrtar për O&M (8)	
Kryetehnik	
Tehnik specialist	

OPERIM DHE INSTALIME

Kryesues	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS (montim demontim) 8	

RRJETI I QASJES FIKS

PERKRAHJA DHE KONTROLI TEKNIK

Kryesues	
Inxhinier	
Kryetehnik	
Tehnik specialist	

NYJET E QASJES - QENDRA

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Operator	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS	
Tehnik FS	

FEEK

SERVISIMI QENDROR

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Inxhinier	
Kryetehnik	
Tehnik specialist	
Tehnik	

RIDREJTUES, UPS, KLIMAT DHE PROJEKTIM

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Inxhinier	
Kryetehnik	
Tehnik specialist	
Tehnik	



BSS_IT

BILLING

BILLING POSTPAID

Kryesues	
Inxhinier specialist	
Administrator	
Teknik specialist	

BILLING PREPAID

Kryesues	
Inxhinier ispecialist	
Administrator i larte	
Administrator i sistemit	
Kryeteknik	

VAS

Inxhinier specialist	
Administrator i sistemit	
Kryeteknik	

CRM

CRM MOBILE

Inxhinier Specialist	
Administrator DB	
Operator	
Kryeteknik dhe Teknik specialist	

CRM FIKS

Inxhinier Specialist	
Administrator DB	
Operator	
Kryeteknik dhe Teknik specialist	

DATA WAREHOUSE

Administrator i Larte DWH	
Administrator DB	

BRM

Mbikqyres ne BRM	
Zyrtar ne BRM	

SOFTWARE DEVELOPMENT

Zhvillues i larte i SW	
Zhvillues i SW	

IT

SYSTEM ADMINISTRATORS

Kryesues is SYSADMIN	
Administrator i larte	
Administrator i sistemit	

NOS

Kryesues ne NOS	
Administrator i Rrjetit	

DB ERP

Administrator i Larte ne ERP	
Administrator i DB	
Operator	

HELP DESK


Mbikqyres ne HELPDESK	
Specialist ne HELPDESK	




INTERKONEKSION DHE ROAMING



REGJIONI I PRISHTINES



REGIONET TJERA



Rrjeti primar	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS	
Tehnik FS	
Rrjeti sekondar	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS	
Tehnik FS	
MDF-ODF	
Kryetehnik	
Tehnik Specialist	
Tehnik	
Mbështetja teknike	
Kryetehnik	
Tehnik specialist	
Tehnik	
Njesia Komunale	
Inxhinier specialist	

Nyjet e Qasjes	
Inxhinier i specialist	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS	
Tehnik FS	
TRANSMETIMI & FS & WiFi OffLoad	
Inxhinier i specialist	
Kryetehnik FS	
Tehnik specialist FS	
Tehnik FS	
FEEK	
Inxhinier i specialist	
Kryetehnik FS	
Tehnik Specialist	
Tehnik	

Planikim/zgjerim dhe implementim	
Inxhinier ispecialist	
Kryetehnik, Teknik specialist, Teknik	





Kryeshefi



Njësia



Departamenti



Sektori



Nënsektori



Ekipi



Zyrtari



Zyra Administrative



Kryeshefi



Departamenti



Nënsektori



Zyrtari



Njësia



Sektori



Ekipi



Zyra Administrative



Njësia



Sektori



Ekipi



Zyra Administrative



Departamenti




Nënsektori



Zyrtari





TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Në përputhje me Ligjin Nr.03/L-212 të Punës ("Ligji i Punës"), Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, sikurse është ndryshuar dhe amandamentuar me Ligjin Nr.04/L-111, dhe Nr.05/L-009 ("Ligji për Ndërmarrjet Publike"), Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare ("Ligji për Shoqëritë Tregtare"), Rregulloren e Punës të Telekomit të Kosovës, Nr.01-2978/22, e datës 27.06.2022 ("Rregullorja e Punës"), si dhe në përputhje me dispozitat e Statutit të Telekomit të Kosovës Sh.A.,

Bordi i Drejtorëve i Telekomit të Kosovës Sh.A. në mbledhjen Nr. 30 të datës 31.08.2022 miratoi këtë:

RREGULLORE

**PËR SISTEMIMIN NË VENDE TË PUNËS GJATË PROCESIT TË RISTRUKTURIMIT
DHE RIORGANIZIMIT TË TELEKOMIT TË KOSOVËS SH.A.**

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi	3
Neni 2 - Fushëveprimi	3
Neni 3 - Përkufizimet	3

KAPITULLI II

PROCEDURAT E RISTRUKTURIMIT, RICAKTIMIT DHE SHUARJES SË VENDEVE TË PUNËS

Neni 4 - Fazat e ristrukturimit të vendeve të punës	4
Neni 5 - Pozitat menaxheriale që i nënshtrohen ristrukturimit dhe ricaktimit	4
Neni 6 - Përzgjedhja e pozitave menaxheriale sipas konkursit të brendshëm me pozitë ekuivalente	4
Neni 7 - Pozitat profesionale dhe/ose administrative që i nënshtrohen ristrukturimit dhe ricaktimit	5
Neni 8 - Ricaktimi i pozitave profesionale dhe/ose administrative	5
Neni 9 - Shuarja e vendeve të punës	6
Neni 10 - Komisionet	6

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11 - Hyrja në fuqi	6
-------------------------	---

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 - Qëllimi

1.1. Kjo Rregullore për Sistemin në Vende të Punës gjatë Procesit të Ristrukturimit dhe Riorganizimit të Telekomit të Kosovës Sh.A. ("**Rregullorja**"), përcakton procedurat dhe kriteret të cilat zbatohen me rastin e riorganizimit dhe ristrukturimit të punës dhe strukturës organizative të Telekomit të Kosovës, që përfshinë dhe nuk kufizohet në ndryshimin e sistemit të vendeve të punës, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi dhe ndryshimin e Strukturës Organizative (Organogramit).

1.2. Kjo Rregullore gjithashtu përcakton procedurat dhe kriteret që zbatohen në procesin e ristrukturimit dhe riorganizimit të Telekomit të Kosovës, duke përfshirë ricaktimet e vendeve të punës në strukturën e re organizative sipas ekuivalencës, procedurën e konkursit, apo shuarjen e vendeve të punës si pasojë e ristrukturimit të ndodhur, konform dispozitave të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212, Rregullores së Punës të Telekomit të Kosovës, Nr.01-2978/22, e datës 27.06.2022 ("**Rregullorja e Punës**"), dhe konform Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. të aprovuar me datë 13.09.2022

1.3. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen konform Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. të aprovuar me datë 13.09.2022 nga Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A.

Neni 2 - Fushëveprimi

2.1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për të gjitha njësitë organizative dhe punonjësit e TK Sh.A.

Neni 3 - Përkufizimet

3.1. Për nevojat e kësaj Rregulloreje, shprehjet e përdorura kanë këto kuptime:

3.1.1. "**Bordi i Drejtorëve**" i TK Sh.A. - nënkupton organin më të lartë, të përcaktuar sipas nenit 15 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nga Aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës).

3.1.2. "**Punonjës**" apo "**i/e Punësuar**" - nënkupton personelin e punësuar në TK Sh.A. me Kontratë të Punës, përgjegjës për të kryer punë ose shërbime kundrejt pagesës për punëdhënësin;

3.1.3. "**Strukturë e vjetër organizative**" - nënkupton strukturën organizative, organogramin dhe përshkrimin e detyrave të vendit të punës për të gjithë punonjësit e Telekomit të Kosovës para hyrjes në fuqi të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. të aprovuar me datë 13.09.2022 nga Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A.

3.1.4. "**Struktura e re organizative**" - nënkupton strukturën organizative, organogramin dhe përshkrimin e detyrave të vendit të punës për të gjithë Punonjësit e Telekomit të Kosovës pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. të aprovuar me datë 13.09.2022 nga Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A.

3.1.5. "**Vendi i punës**" apo "**pozita e punës**" - kanë kuptimin e njëjtë, por njëri apo tjetri emërtim përdoret përshatshëmrisht me kontekstin e fjalisë, dhe nënkupton vendin e punës për të cilin i punësuar ka lidhur Kontratë Pune.

3.1.6. "**Grada**" - është vlerë numerike, e cila reflekton pozicionin e një vendi të punës në hierarkinë e përgjegjësi dhe pagën.

3.1.7. "**Paga**" - nënkupton vlerën monetare që përfitojnë punonjësit si rezultat i gradës për angazhimin e tyre në punë.

3.2. Për të gjitha shprehjet tjera, aplikohen përkufizimet në përputhje me Rregulloren e Punës të Telekomit të Kosovës, Nr.01-2978/22, të datës 27.06.2022, dhe Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A., Nr. 01-3943/22, të aprovuar me datë 13.09.2022 nga Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A. bashkë me shtojcat e aplikueshme.

KAPITULLI II

PROCEDURAT E RISTRUKTURIMIT, RICAKTIMIT DHE SHUARJES SË VENDEVE TË PUNËS

Neni 4 - Fazat e ristrukturimit të vendeve të punës

4.1. Ristrukturimi dhe riorganizimi i Telekomit të Kosovës, duke përfshirë edhe ndryshimet në skemën organizative, do t'i nënshtrohet dy fazave të ndryshme:

- Pozitat menaxheriale si fazë e parë, dhe
- Pozitat profesionale dhe/ose administrative si fazë e dytë.

4.2. Ristrukturimi i pozitave menaxheriale është faza e parë e zbatimit të ristrukturimit, konform procedurave dhe kriterëve të vendosura në këtë Rregullore, për njësitë e reja të strukturës organizative të organogramit, të krijuara si rezultat i aprovimit të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. Nr. 01-3943/22, datë 13.09.2022 nga Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A.

4.3. Pas përfundimit të ristrukturimit të fazës së parë, brenda një periudhe të arsyeshme kohore, secili punonjës në pozitën menaxheriale të ricaktuar vendos lidhur me numrin e përgjithshëm të punonjësve në nivel të njësisë. Numri i përgjithshëm merr për konsideratë kriteret objektive dhe jodiskriminuese.

Neni 5 - Pozitat menaxheriale që i nënshtrohen ristrukturimit dhe ricaktimit

5.1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, punonjës me pozitë menaxheriale në Telekomin e Kosovës, konsiderohen të gjithë punonjësit që sipas Strukturës së vjetër organizative (organogramit të vjetër) kanë pasur gradat 12 – 18. Kjo përfshin Strukturën e vjetër organizative, të shfuqizuar me Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. Nr. 01-3943/22 datë 13.09.2022

5.2. Pavarësisht nga pika 5.1 e këtij neni, pozitë menaxheriale konsiderohet edhe vendi i punës që sipas organogramit të vjetër tanimë të shfuqizuar, nuk e ka pasur njërin nga gradat e sipërpërmendura (12-18), por, nga titulli i pozitës "Kordinator" ose "Udhëheqës Ekipi" dhe/ose detyrave të punës, konstatohet se ka ushtruar përgjegjësi menaxheriale.

5.3. Përgjashtimisht nga pika 5.1 e këtij neni, pozitë menaxheriale nuk konsiderohet vendi i punës i cili e ka njërin prej gradave të sipërpërmendura (12-18) por, nga titulli i pozitës dhe/ose detyrave të punës konstatohet se nuk ka ushtruar përgjegjësi menaxheriale.

Neni 6 - Përzgjedhja e pozitave menaxheriale sipas konkursit të brendshëm me pozitë ekuivalente

6.1. Telekom i Kosovës do të hapë konkurs të brendshëm për të gjitha pozitat menaxheriale në kuadër të Strukturës së re organizative (organogramit të ri) të cilat kanë grada 12 – 18 sipas Strukturës së re organizative (nënkupton strukturën organizative, organogramin dhe përshkrimin e detyrave të vendit të punës për të gjithë punonjësit e Telekomit të Kosovës, pas hyrjes në fuqi të Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A. të aprovuar me datë 13.09.2022 nga Bordi i Drejtorëve të TK Sh.A).

6.2. Telekom i Kosovës gjithashtu do të hapë konkurs të brendshëm për të gjitha pozitat menaxheriale në kuadër të Strukturës së re organizative (organogramin e ri), të cilat janë ekuivalente me pozitat menaxheriale në kuadër të Strukturës së vjetër organizative (organogramit të vjetër), të identifikuar sipas nenit 5 të kësaj Rregulloreje. Rrjedhimisht, të gjithë të punësuarit e Telekomit të Kosovës, duke përfshirë personat të cilat kanë mbajtur pozita menaxheriale sipas Nenit 5 në Strukturën e vjetër organizative

(organogramin e vjetër), kanë të drejtë të aplikojnë dhe do t'i nënshtrohen konkursit të brendshëm për t'u caktuar në pozita në Strukturën e re organizative (organogramin e ri).

6.3. Konkursi i brendshëm organizohet konform rregulloreve të brendshme të Telekomit të Kosovës, Rregullores së Punës të Telekomit të Kosovës, Nr.01-2978/22, e datës 27.06.2022, dhe Konkursi do të jetë i hapur për të gjithë të punësuarit e Telekomit të Kosovës që i përmbushin kriteret, dhe bazohet mbi kriteret objektive dhe jodiskriminuese.

6.4. Pas përfundimit të konkursit të brendshëm, pozitat menaxheriale ricaktohen në organogramin e ri, konform rezultateve të konkursit të brendshëm, me pozitë dhe pagë ekuivalente.

6.5. Për punonjësit e nivelit menaxherial që mbesin të pa ricaktuar konform këtij neni, përshtatshmërisht zbatohen neni 8 dhe neni 9 i kësaj Rregulloreje.

Neni 7 - Pozitat profesionale dhe/ose administrative që i nënshtrohen ristrukturimit dhe ri-caktimit

7.1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, punonjës me pozitë profesionale dhe/ose administrative në Telekomin e Kosovës, konsiderohen të gjithë punonjësit që sipas organogramit të vjetër të shfuqizuar me Rregulloren për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës SH.A, Nr. 01-3943/22, datë 13-09-2022, kanë pasur gradat 1-11 dhe të cilët nuk klasifikohen për pozita menaxheriale në përputhje me Nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 8 - Ricaktimi i pozitave profesionale dhe/ose administrative

8.1. Vendet e punës të pozitave profesionale dhe/ose administrative të njësisë së vjetër **ricaktohen** në njësinë e re organizative të TK Sh. A. në bazë të organogramit të ri në **pozita ekuivalente**, kjo duke marrë parasysh punët dhe detyrat e punës, përgjegjësitë, kualifikimin profesional të kërkuar, dhe pagën ekuivalente.

8.2. Në qoftë se ricaktimi në vendet e pozitave profesionale dhe/ose administrative në njësinë e re organizative të TK Sh. A. sipas pikës 8.1 të këtij neni nuk është i mundur për një numër punonjësish, për shkak se njësia organizative ka pësuar rënie në numrin e përgjithshëm të punonjësve dhe pozitave të punës në atë njësi, atëherë punonjësit me pozitë profesionale dhe/ose administrative i nënshtrohen një procesi përzgjedhës mbi këto kriteret:

8.2.1. Përvoja e punës në fushën përkatëse në TK Sh.A.;

8.2.2. Përgatitja profesionale; dhe

8.2.3. Pikët në intervistë.

8.3. Procesi i përzgjedhjes bëhet duke vlerësuar kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara në pikën 8.2. nga Komisioni përzgjedhës.

8.4. Në qoftë se vendet e pozitave profesionale dhe/ose administrative në një njësi të re organizative të TK Sh. A. pësojnë rritje në numrin e përgjithshëm, e si rezultat i kësaj mbesin vende të lira pas ricaktimit të punonjësve sipas pikës 8.1, atëherë punonjësit e paricaktuar sipas pikës 8.2 ose sipas pikës 6.4, mund të aplikojnë brenda tridhjetë (30) ditëve për pozitën e lirë në njësinë përkatëse organizative ku janë identifikuar pozita të lira, pavarësisht faktit nëse pozita e lirë nuk korrespondon si pozitë ose pagë ekuivalente.

8.5. Të gjithë punonjësit të cilët nuk përzgjidhen në pozitën ku kanë aplikuar në përputhje me Nenin 8.2 dhe 8.3, kanë përparësi ndaj punonjësve tjerë në rast se aplikojnë për pozitat e punës të cilat janë të lira në kuadër të Strukturës së re organizative (organogramit të ri).

8.6. Në rast se të punësuarit nuk aplikojnë apo nuk janë të interesuar të aplikojnë për vende të lira në përputhje me Nenin 8.5, apo në rast se refuzojnë propozimet e Telekomit të Kosovës për risistemim në pozitat e lira të punës në Strukturën e re organizative (organogramin e ri), ndaj tyre zbatohen procedurat e përcaktuara me nenin 70 të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212.

Neni 9 - Shuarja e vendeve të punës

9.1. Punonjësit të cilët mbesin të pa ricaktuar sipas Nenit 6 dhe 8 të kësaj Rregulloreje, i nënshtrohen këtij Neni të Rregullores dhe nenit 70, 71 dhe 76 të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212.

9.2. Në rast të shuarjes së pozitës dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës, Telekom i Kosovës do të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 71 dhe 76 të Ligjit të Punës, Nr.03/L-212 për përcaktimin e afateve të paralajmërimit dhe të kompensimit të pagave.

Neni 10 - Komisionet

Me qëllim të implementimit të procedurave të ristrukturimit dhe ricaktimit në kuadër të kësaj Rregulloreje, dhe gjithashtu për menaxhimin e konkurseve, themelohen komisionet në përputhje me Rregulloren e Punës, Nr.01-2978/22, e datës 27.06.2022

KAPITULLI III

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 11 - Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Bordi i Drejtorëve dhe zbatohet nga dita e miratimit të saj deri në përfundimin e procesit të riorganizimit dhe ristrukturimit. Për aspektet të cilat nuk rregullohen me këtë Rregullore, zbatohen në mënyrë të përshtatshme dispozitat e Rregullores së Punës të Telekomit të Kosovës, Nr.01-2978/22, e datës 27.06.2022, dhe Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Telekomin e Kosovës Sh.A, Nr. 01-3943/22, e datës 13.09.2022, bashkë me shtojcat e aplikueshme.

z. Shpëtim Dobra

Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A.



Telekomi i Kosovës SH. A.
Kosovo Telecom J. S. C.
Telekom Kosovo D. D.
Nr./No./Dr. 01-3946/22
Data/Date/Datum 13-09/22
PRISHTINË, PRISTINA, PRISTINA



TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.

Mbështetur në Kreun VII-Pagat dhe Beneficionet e të Punësuarve, respektivisht në nenet nga 55 deri 66 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në bazë të autorizimeve ligjore të përcaktuara me nenin 20 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 04/L-111, nenit 130 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr. 06/L-016 dhe autorizimeve statutare sipas nenit 24 të Statutit të Telekomit të Kosovës Sh.A.,

Bordi i Drejtorëve i Telekomit të Kosovës Sh.A. në mbledhjen Nr. 30 të datës 31-08-2022 miratoi këtë:

RREGULLORE

PËR PAGAT, SHITESAT MBI PAGË, KOMPENSIMET TJERA DHE NDALESAT NË PAGË

PJESA I

PARIMET THEMELORE

Neni 1 - Qëllimi	3
Neni 2 - Fusha e zbatimit	3
Neni 3 - Parimet bazë	3
Neni 4 - Përkufizimet	4

PJESA II

PAGA E TË PUNËSUARIT

Neni 5 - Paga bazë	4
Neni 6 - Përfshirja në sistem	4
Neni 7 - Forma dhe procedura e pagesës së pagave	4

KAPITULLI III

SHTESAT

Neni 8 - Shtesat mbi pagë	5
Neni 9 - Shtesa për punët me rrezikshmëri	5

PJESA IV

PARIMET THEMELORE

Neni 10 - Kompensimi i pagës në rast të mungesës	5
Neni 11 - Kompensimi i pushimit mjekësor	6
Neni 12 - Kompensimi për aftësimin profesional dhe kompensimi i mëditjeve për udhëtime zyrtare	6
Neni 13 - Kompensimi në rast të vdekjes	6

KAPITULLI V

NDALESAT

Neni 14 - Ndalesat në pagë	6
----------------------------	---

KAPITULLI VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15 - Çështjet tjera	7
Neni 16 - Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores	7
Neni 17 - Hyrja në fuqi	7

PJESA I

PARIMET THEMELORE

Neni 1 - Qëllimi

1.1. Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e pagave dhe beneficioneve tjera të të punësuarve, shtesave mbi pagë, kompensimeve tjera dhe ndalesave në pagë për të punësuarit në Telekomin e Kosovës Sh.A., në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm, rregulloret e brendshme të Telekomit të Kosovës dhe strukturën e gradave të organizimit të brendshëm.

Neni 2 - Fusha e zbatimit

2.1. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë të punësuarit në Telekomin e Kosovës Sh.A., përpos për zyrtarët e lartë të korporatës të zgjedhur sipas dispozitës së nenit 21 të Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike.

2.2. Pagat dhe përfitimet e zyrtarëve të lartë menaxhues në Telekomin e Kosovës, do të përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve bazuar në Politikën për Kompensimin e Zyrtarëve të Lartë dhe sipas dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Neni 3 - Parimet bazë

3.1. Pagat në Telekomin e Kosovës Sh.A., përcaktohen sipas parimeve të mëposhtme:

3.1.1. Parimi i barabarësisë - Secili pjesëtar merr pagë të barabartë për gradën që bartë, funksionin në pozita të krahasueshme me gradat e njëjta. Gradat janë të përcaktuara sipas rregulloreve dhe akteve tjera ligjore të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A.

3.1.2. Parimi i transparencës - Pagat janë transparente dhe ofrojnë bazë për planifikimin e shpenzimeve vjetore.

3.1.3. Parimi i ligjshmërisë - Pagat e punonjësve në TK përcaktohen në pajtim me këtë Rregullore dhe aktet tjera normative të mbështetura në dispozitat e legjislacionit aplikativ.

3.1.4. Parimi i mosdiskriminimit - Asnjë përfitues i pagës sipas gradës nuk diskriminohet në pagë, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Neni 4 - Përkufizimet

"TK"	Telekomi i Kosovës Sh.A.
"I punësuar"	Personi fizik i cili ka themeluar marrëdhënien e punës me TK me Kontratën e Punës sipas legjislacionit në fuqi
"Grada"	Shenja dalluese që përcakton pagën, hierarkinë organizative dhe përfshinë rendin e përgjegjësi dhe funksioneve
"Paga"	Vlera monetare që përfiton i punësuar si rezultat i gradës, për angazhimin e tij në punë.
"Vlera bruto"	Vlera e pagës dhe kompensimeve tjera monetare, para ndaljes së detyrimeve tatimore mbi të ardhurat personale dhe të kontributeve pensionale
"Vlera neto"	Vlera e pagës dhe kompensimeve tjera monetare, pasi të ndalen detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale dhe të kontributeve pensionale
"Udhëtim zyrtar"	Udhëtim jashtë vendit për interes dhe nevojat e TK-së
"Masa disiplinore"	Secila masë e shqiptuar nga organi kompetent sipas aktit të brendshëm normativ të TK-së
"Anëtar i ngushtë i familjes"	Siç përcaktohet me Ligjin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës

PJESA II

PAGA E TË PUNËSUARIT

Neni 5 - Paga bazë

5.1. I punësuar ka të drejtë në pagën bazë sipas gradimit e cila përcaktohet në Kontratën e Punës dhe aktet e brendshme të Telekomit të Kosovës, kjo në pajtim me Ligjin e Punës dhe legjislacionin tjetër primar dhe sekondar në fuqi.

5.2. Niveli i pagës bazë në vlerën bruto për secilën gradë, është pasqyruar në Tabelën e Shtojcës Nr. 1, e cila është pjesë përbërëse e kësaj Rregullore, me vlerat aktuale të pagave të aprovuara nga Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të TK Sh.A., me vendim Nr. 01-1461/20 dt.15.05.2020 dhe me Vendim të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve TK Sh.A., nr.01-1527/20 dt.22.05.2020.

Neni 6 - Përfshirja në sistem

6.1. Përfshirja në sistemin e pagave bëhet nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës së Punës.

6.2. Me rastin e ngritjes apo zbritjes të gradës së punonjësit, niveli i pagës sipas gradës së re do të llogaritet nga data e hyrjes në fuqi të aktit juridik për gradimin e ri.

Neni 7 - Forma dhe procedura e pagesës së pagave

7.1. Paga mujore paguhet për çdo muaj në Euro (€).

7.2. Pagesa e pagës bëhet përmes transferit bankar, në llogarinë rrjedhëse të përcaktuar nga ana e punëtorit, në përputhje me Ligjin e Punës, Rregulloren për Sistemimin e Vendeve të Punës dhe akteve të brendshme të TK Sh.A .

7.3. Menaxhmenti i TK-së, ka të drejtë që për shkaqe të arsyeshme ta ndryshon formën e pagesës së pagës të përshkruar në paragrafin paraprak, por vetëm deri sa të ekzistojnë ato shkaqe.

7.4. Pagesa e pagës bëhet sipas sistemit të menaxhuar nga organi kompetent i TK-së, duke ia transferuar të punësuarit pagën në llogarinë e tij bankare.

7.5. Të punësuarit i transferohet në llogarinë e tij paga në vlerën neto, duke i aplikuar ndaljet në burim të tatimit mbi të ardhurat personale, kontributet pensionale dhe të gjitha detyrimet tjera sikurse mund të përcaktohen me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës.

7.6. I punësuar ka të drejtë që në secilin rast të njoftohet për strukturën dhe të gjitha çështjet tjera që lidhen me pagën e tij.

7.7. Në rast të konstatimit të gabimit në llogaritjen e pagës, organi kompetent i TK-së, është i obliguar që menjëherë ta përmirëson gabimin në përputhje me legjislacionin në fuqi.

PJESA III

SHTESAT

Neni 8 - Shtesat mbi pagë

8.1. I punësuar ka të drejtë në shtesat mbi pagë sipas Ligjit të Punës dhe legjislacionit tjetër primar dhe sekondar në fuqi.

8.2. Shtesat mbi pagë aplikohen në përputhje me Rregulloren për Marrëdhënien e Punës në TK Sh.A., Nr.01-2978/22, të dt.27.06.2022, dhe përfshijnë shtesat:

8.2.1. për punën jashtë orarit të rregullt të punës;

8.2.2. për punën gjatë fundjavës;

8.2.3. për punën në ditët e festave zyrtare;

8.2.4. për punën gjatë natës;

8.3. Me rastin e pensionimit të rregullt, punonjësi gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) pagave mujore, sipas pagës të realizuar në 3 (tre) muajt e fundit, para pensionimit.

Neni 9 - Shtesa për punët me rrezikshmëri

9.1. Mbrojtja dhe siguria në punë, dhe të drejtat e punonjësve të cilët janë të angazhuar në punë me rrezikshmëri përcaktohen në përputhje me Rregulloren për Marrëdhënien e Punës në TK Sh.A., Nr.01-2978/22, të dt.27.06.2022.

9.2. Kompensimi i shtesave për punët me rrezikshmëri mund të bëhet në bazë të shkallës së rrezikshmërisë të paraparë me aktin e brendshëm të TK-së, sipas kërkesës së eprorit përgjegjës dhe pas miratimit nga një Komision i TK-së i caktuar posaçërisht për këtë qëllim. Kompensimi dhe pagesa e shtesave për punët me rrezikshmëri bëhet vetëm në bazë të vendimit të Komisionit, dhe asnjë e drejtë nuk mund të krijohet për punëtor në mungesë të një vendimi të tillë me shkrim.

9.3. Shtesa për punët me rrezikshmëri mund të zbatohet nga TK pas vlerësimit të mundësive financiare.

PJESA IV

KOMPENSIMET TJERA

Neni 10 - Kompensimi i pagës në rast të mungesës

10.1. Punonjësi ka të drejtë për kompensimin e plotë të pagës në rastet e mungesës në përputhje me Rregulloren për Marrëdhënien e Punës në TK Sh.A., Nr.01-2978/22, të dt.27.06.2022, e që përfshinë rastet e mëposhtme:

10.1.1. gjatë ditëve të festave zyrtare në të cilat nuk punohet;

10.1.2. gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor;

10.1.3. gjatë aftësisimit profesional për të cilën është dërguar nga TK dhe për nevojat e TK-së, dhe,

10.1.4. gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet.

Neni 11 - Kompensimi i pushimit mjekësor

11.1. Pushimi mjekësor kompensohet në përputhje me Rregulloren për Marrëdhënien e Punës në TK Sh.A., Nr.01-2978/22, të dt.27.06.2022.

Neni 12 - Kompensimi për aftësimin profesional dhe kompensimi i mëditjeve për udhëtime zyrtare

12.1. TK, në përputhje me nevojat e saj për ekspertizë specifike në fusha të caktuara dhe duke udhëhequr procedura transparente dhe konkurruese, mund të aprovojë kompensime për aftësime profesionale të të punësuarve. Kompensimet për aftësimin profesional të të punësuarit për nevojat e TK-së, mbulohen nga TK nëse nuk mbulohen nga ndonjë organizatë tjetër. Lartësia e këtij kompensimi përcaktohet me aktin e veçantë dhe varësisht nga mundësitë financiare të TK-së. Asnjë e drejtë nuk krijohet për aplikuesit deri në një vendim me shkrim të TK-së për aprovimin e kompensimit të programeve për aftësim profesional.

12.2. Gjatë kohës së aftësimit profesional, i punësuarit nuk e humb të drejtën në pagën e rregullt mujore.

12.3. Kompensimet për mëditjet për udhëtime zyrtare i takojnë të punësuarit sipas kritereve të përcaktuara me Rregulloren e brendshme të TK-së për udhëtime zyrtare.

Neni 13 - Kompensimi në rast të vdekjes

13.1. Në rast të vdekjes të të punësuarit të TK-së, familja e ngushtë e punëtorit të vdekur ka të drejtë në kompensimin e ndihmës solidarë, vetëm një herë, nga ana e TK Sh.A., në lartësi prej 250 €.

13.2. Në rast të vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes së punëtorit, të cilët i ka mbajtur punëtori, punëtori kompensohet në lartësi prej 150€ në emër të mbulimit të shpenzimeve të varrimit.

13.3. Anëtarët e familjes së ngushtë përcaktohen në përputhje me ligjin e aplikueshëm, Ligjin për Marrëdhënie të Detyrimeve apo Kodin Civil.

PJESA V NDALESAT

Neni 14 - Ndalesat në pagë

14.1. Të punësuarit të cilit i shqiptohet masa disiplinore në formën e gjobave financiare për cilindo cenim apo me uljen e gradës, merr pagë të zvogëluar apo pagën e gradës më të ulët, në kohëzgjatje sa u është shqiptuar masa disiplinore apo në kohëzgjatje për sa i është ulur grada.

14.2. I punësuarit i cili shkakton dëme materiale në punë apo në lidhje me punën, merr pagën e zvogëluar në proporcion me vlerën e dëmit të shkaktuar dhe deri në kompensimin e plotë të atij dëmi.

14.3. Ndalesat sipas rasteve nga paragrafët paraprakë mund të ekzekutohen pas përfundimit të procedurës përkatëse disiplinore dhe plotfuqishmërisë së vendimit.

PJESA VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15 - Çështjet tjera

15.1. Çështjet të cilat nuk janë të përfshira me këtë Rregullore, do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm dhe aktet tjera të Telekomit të Kosovës.

Neni 16 - Ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores

16.1. Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Bordi i Drejtorëve, në përputhje me kërkesat ligjore, organizative dhe gjendjen financiare në TK.

Neni 17 - Hyrja në fuqi

17.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Bordi i Drejtorëve dhe zbatohet nga dita e miratimit të saj.

z. Shpëtim Dobra

Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A.

